



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E LIRIMIT

LËNDA

“GJUHË GJERMANE”

KOORDINATORE: LUDMILLA STEFANI

VIOLA KARAPICI

VITI SHKOLLOR 2016 – 2017

I. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

Bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, testi i gjuhës së huaj hartohet në përputhje me gjuhën, e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar dhe niveli i njohurive i përket **nivelit gjuhësor A2**, sipas dokumentit evropian “Kuari i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët”.

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës gjermane, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehjet e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale.

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e testit për gjuhën gjermane si provim i detyruar, është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehjeve të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik, ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.

Programi orientues është ndërtuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve dhe zhvillimet e tyre personale, me qëllim që t’iu japë mundësi për sukses në provim.

Synimet e programit

Ky program synon:

- të ndihmojë nxënësin në përgatitjen e tij për provimin e gjuhës gjermane si provim i detyruar;
- të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t’u dhënë orientimet e duhura nxënësve;
- vlerësimin paralel të dy aftësive kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj) dhe dy koncepteve bazë, që janë: “*të lexuarit dhe të kuptuarit*” dhe “*të shprehurit me shkrim*”;
- të japë orientime për specialistët për hartimin e testit për gjuhën gjermane si provim i detyruar .

Udhëzime praktike për përdorimin e programit

Specifika e gjuhës së huaj duhet të kihet parasysh nga mësuesit gjatë përdorimit të këtij programi. Nxënësi në provim do të përballë me situata të reja ose me pjesë të reja leximi, por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato.

Pjesë e testit do të jetë gramatika. Këtu mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi një problem të caktuar gramatikor (Prepositionen, passiv, perfekt, prwteritum, modalverben, konjunktiv II, u.s.w.), duke dalë nga tipi i ushtrimeve tradicionale që jepen nëpër tekste dhe duke praktikuar formate të reja ushtrimesh ku të përfshihen këto aspekte gramatikore, duke e parapërgatitur nxënësin për ato që do trajtohen në provimin e klasës IX. Mësuesi duhet të fokusohet në anën praktike të zgjidhjes së ushtrimeve.

Funksionet gjuhësore të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme, duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës, por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Në to duhet të ndihet rëndësia dhe ndikimi i madh që ka të mësuarit dhe të folurit e gjuhës gjermane.

Në pjesën e të shkruarit mësuesi t'i ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë fjalët në fjali, fjalitë në paragrafë dhe paragrafët në një ese'. Gjithashtu, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të dine të përmbledhin me shkrim një përvojë personale, duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tyre në një tekst koherent. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur të shkruajë një email ose letër jo formale; të zbatojë rregullat e shkrimit.

II. AFTËSITË DHE NJOHURITË QË DUHET TË ZOTËROJË NXËNËSI I KLASËS IX PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E GJUHËS GJERMANE

Nxënësi duhet të demonstrojë **aftësitë dhe njohuritë** e tij për çka më poshtë vijon:

1. Të kuptuarit me shkrim (leseverstehen)

Vlerësimi i këtij komponenti do të bëhet mbi bazën e një teksti të panjohur mbi të cilin do të ndërtohen pyetje që do të testojnë aftësinë e nxënësit për të kuptuar një pjesë letrare ose jo letrare dhe për të gjykuar mbi të.

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë të përgjithshme informacionin e dhënë në pjesën e leximit, të mbledhë informacionet që i kërkohen rreth tekstit apo të japë një vlerësimin të shprehur me gjuhë të thjeshtë mbi atë çka i kërkohet.

Më poshtë po renditim disa aspekte të leximit:

- Marrja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë.
- Reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të duhur prej tij.
- Thellim në kuptimin e një fraze dhe gjetja e sinonimit të saj.
- Formimi i një kuptimi të përgjithshëm dhe nxjerrja e moralit të pjesës, shprehur me gjuhë të thjeshtë.
- Paraqitja e elementeve që justifikojnë përgjigjen e dhënë.
- Plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit.
- Gjetja e fjalëve referuese.

2. Të shprehurit me shkrim

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të prodhojë tekste të shkruara mbi një gamë jo shumë të gjerë temash duke i lidhur elementët në mënyrë koherente, duhet të jetë në gjendje të bëjë përshkrime jo shumë të hollësishme mbi tema të njohura, të tregojë me shkrim përvojat e tij duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real duke përdorur gjuhë të thjeshtë dhe të pangarkuar me detaje, të shkruajë një letër personale apo zyrtare, një email formal të thjeshtë dhe joformal duke respektuar formatet e mësuara gjatë viteve që nxënësi ka studiuar këtë gjuhë etj.

Për vlerësimin e kësaj aftësie nxënësi duhet të paraqesë një produkt të shkruar prej **60-80** fjalësh. Nxënësi vlerësohet për përmbajtjen, leksikun, korrektësinë gramatikore, strukturën e rrjedhën logjike.

Të shprehurit me shkrim përfshin:

- të shprehurit me shkrim në formën e një përshkrimi, letre etj., për një gamë të gjerë temash të njohura e komplekse që janë trajtuar ndër vite në nivelin **A2**;
- një produkt të shkruar saktë nga ana gramatikore dhe të strukturuar mirë;

- shprehjen e pikëpamjeve në formë të thjeshtë dhe të qartë;
- përdorimin e një repertori të thjeshtë leksikor;
- komente të shkurtra me shkrim për probleme të ndryshme;
- të ruajë rendin e mendimeve në të gjithë pjesën e shkruar.

3. Përdorimi i gjuhës

Në këtë program njohuritë kryesore që nxënësi ka marrë mbi përdorimin e gjuhës ndër vite, janë të dhëna përmes ushtrimeve, temave, bashkëbisedimeve që trajtojnë njësi të ndryshme gramatikore ose leksikore, pra në mënyrë esenciale fjalori dhe gramatika e mësuar.

Tipet e ushtrimeve të rekomanduara për fushat e sipërpërmendura

TË KUPTUARIT ME SHKRIM (LESEVERSTEHEN)
<ul style="list-style-type: none"> • Pyetje mbi përmbajtjen e tekstit. • Ushtrime me përzgjedhje fjalësh ose frazash. • Plotësimi i vendeve bosh me informacionin e duhur. • Ushtrime me përgjigje <i>po/jo</i>. • Ushtrime me <i>e vërtetë/e rreme</i>. • Ushtrime me disa alternativa, përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna). • Ushtrime ku i kërkohet marrja dhe përzgjedhja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë. • Ushtrime ku i kërkohet reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të duhur prej tij. • Vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve. • Ushtrime ku i kërkohet paraqitja e elementëve provues që mbështesin idenë e dhënë nga vetë nxënësi. • Ushtrime ku i kërkohet thellim në kuptimin e një fraze dhe gjetja e sinonimit të saj.
PËRDORIM I GJUHËS (WORTSCHATZ UND GRAMMATIK).
<ul style="list-style-type: none"> • Ushtrime me zëvendësim. • Ushtrime transformimi.

- Ushtrime me alternativa.
- Ushtrime me plotësime vendesh bosh.
- Ushtrime ndërtim fjalish.
- Ushtrime bashkim fjalësh me kuptimin, gjetje gabimesh.
- Bashkim funksioni me strukturën përkatëse.
- Gjetja e sinonimeve dhe e antonimeve.
- Shprehja e të njëjtit kuptim, me fjalë të tjera.

TË SHKRUARIT (SCHRIFTLICHER AUSDRUCK).

- Shkrimi i një *email*-i ose letër personale e thjeshtë, ku i tregohet një miku rreth një eksperience që ka lënë mbresa
- Shprehja e mendimit rreth një çështjeje të caktuar
- Letër falënderimi
- Ftesa
- Mesazhe
- Përshkrime të thjeshta nga jeta e përditshme si: njerëz, vende, ngjarje

III. STRUKTURA E PROVIMIT NË PËRQINDJE

Aspektet Gjuhësore që do të vlerësohen	Përqindja
Të kuptuarit me shkrim (Leseverstehen).	40%
Përdorimi i gjuhës (Wortschatz und grammatik).	40%
Të shprehurit me shkrim (Schriftlicher ausdruck)	20%

IV. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Fushat tematike dhe leksiku

Përmbajtja tematike është mbështetur në programin edhe tekstet shkollore për gjuhën gjermane. Tematika e mëposhtme, e parashikuar do të përfshijë temat bazë (sipas kurrikulës) dhe nëntema të marra nga kurrikula dhe tekstet.

Temat janë formular në mënyrë përgjithësuese dhe jo sipas titujve të teksteve dhe përfshijnë ato njohuri, të cilat janë zhvilluar përmes mësimave.

Erlebnisbereich ‘Ich als Person’.

- Persönliche Daten, Lebenslauf.
- Aussehen und Geschmack.
- Gesundheit, Krankheit.
- Kleidung.
- Tagesablauf.
- Hobbys und Freizeit.

Erlebnisbereich ‘Unmittelbare Umgebung’.

- Familie, Freunde und Bekannte, Nachbarn.
- “Familie” definieren/ Familienaufgaben.
- Eine kleine oder eine grosse Familie haben?- Rollenverteilung.
- Familienfeste und Geschenke, Essen und trinken.
- Wohnung, Umzug und Einrichtung.
- Jugend und ihre Probleme /Jugend “ definieren.
- Sport und Fitness.
- Die Liebe hat keine Grenze- Liebeskummer.
- Träume und Wünsche definieren.
- Auf dem Land /in der Stadt.

Erlebnisbereich ‘Weitere Umgebung’.

- Fremd(e).
- Reise – Impressionen / Reisepläne.
- Urlaub.
- Heimat: Was ist Heimat? Einen Begriff umschreiben.
- Kommunikation.
- Lebensstationen.
- Schule und Schulerfahrungen.
- Ausbildung und Berufswege.

- Arbeitswelt und Karriere.
- Warenwelt.

Vermittelte Erlebnisbereich.

- Massenmedien.
- Nachrichten und Berichte.
- Medien und Werbung – Mit Medien durch den Tag.
- Sprachunterricht mit/ohne Medien.
- Landeskunde und interkulturelles Lernen.
- Das eigene Land.
- Deutschsprachige Länder.
- Aus der Politik und Geschichte.

Funktionen der Kommunikation

Propositionen und die Funktionen der Kommunikation:

- Eigene Meinungen äußern: meiner Meinung nach...; Ich bin mir sicher dass...;
- Ich würde sagen ...; usw.
- Vermutungen, Behauptungen formulieren: Ich behaupte...; Ich vermute...; Ich glaube...; Kann sein dass...; Wahrscheinlich...; usw.
- Sich pro und kontra äußern: Ich stimme zu; Ich bin dafür; Ich bin völlig dagegen. usw.
- Über eigene Erfahrungen berichten. Über Ereignisse in der Vergangenheit berichten.
- Etwas Irreales ausdrücken.
- Ratschläge geben, um Rat bitten.
- Gefallen, missfallen ausdrücken.
- Gefühle ausdrücken, Wünsche äußern, Glückwünsche aussprechen.
- Informieren und nachfragen.
- Etwas begründen, etwas beurteilen, etwas bewerten, vergleichen, Verständnis zeigen, erstaunt oder kritisch reagieren.

Elemente der Grammatik

Für die Kommunikation sind die Grammatik vorgeschrieben. Die Grammatik der Kommunikation:

- Verb: Präsens.

- Perfekt, präteritum.
- Futur 1, plusquam perfekt.
- Passiv.
- Konjunktiv II.
- Regelmässige, unregelmässige verbena.
- Trennbare verbena.
- Modalverben.
- Partizip I und II.
- Unbestimmter, bestimmter artikel, negativartikel, frageartikel.
- Substantiv: singular, plural.
- Deklination des substantivs.
- Adjektiv: adjektivideklination und graduierung.
- Prädikativ, attributives adjektiv.
- Verb und ergänzungen, akkusativ - und dativergänzung: stellung im satz.
- Infinitiv mit zu.
- Präpositionen mit akkussativ, dativ, genitiv, wechselfräpositionen.
- Präpositionaladverbien.
- Verben mit reflexivpronomen.
- Possessivartikel.
- Demonstrativartikel: dieser, dieses, diese.
- Indefinitpronomen.
- Nebensätze:/ kausalsätze.
- Temporale nebensätze.
- Konsekutivsätze / finalsätze / konzessivsätze.
- Relativsatz / relativpronomen.
- Konditionalsatz.
- Temporal – kausal – modal – lokalangaben.
- Verben mit präpositional – ergänzungen.
- Funktionsverb – gefüge.

- Wortbildung: substantive aus verbena.
- Imperativ.
- Konjunktionen.
- Direktionaladverbien.
- Ordinalzahlen.